



Shqipëria, 'kolonia hebraike' e Europës

Alfred Lela

Sot mbahet Konferenca e parë Ndërqeveritare në Bruksel. Pas zhbllokimit që parlamentet e Bullgarisë dhe Maqedonisë së Veriut, i bënë procesit të anëtarësimit, lexo çeljes së negociatave, duket se Tirana dhe Shkupi kthehen në tryezën e bisedimeve si pritës, meritues dhe dëshirues të një PO-je europiane.

E theksoj Tirana dhe Shkupi, jo Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut, për të nënvizuar një proces tëhuajësimi të dy vendeve me procesin në fjalë. E kthyer më shumë në teknikalitet, si gjuhë dhe pengesë për t'u kapërcyer nga qeveritë e dy vendeve, brenda kornizave të proceseve politike vetëpromovuese të brendshme, BE është zhveshur nga kuptimi i parë dhe i kahershëm që popullatat respektive, sidimos shqiptarja, i jepnin asociimit me të.

Duhe pranuar se, në këtë raport gjithnjë e më mekanik, ka luajtur rol edhe një benefit i prekshëm dhe i dukshëm, lëvizja e lire, nëpërmjet inkuadrimit në regjimin europian të vizave. Që kur shqiptarët dolën nga radhët e gjata dhe depersonalizuese në oborret e përparme ose të pasme të ambasadave, Europa nuk shërben më as si shkop dhe as si karrotë. Ajo mund të çmohet, preket, vizitohet, nënçmohet, duke ia nisur së gjithës sërish nga fillimi.

Pasë anuluar qytetarin nga skema e longing for Europe, i gjithë tensioni i ka kaluar establishmentit politik dhe sidomos qeverisë në fuqi. Në një kohë me kaq shumë dizintegritime, paradoksalisht, mungesa e një integrimi, si ai në klubin e vendeve të Europës, bie në sy.

Në Shqipëri, ku gjithçka bie në sy edhe më shumë, mungesa e qoftë edhe një hapi integrues në 8 vjet ngjan si krateri shtratin e të cilit e mbushin vetëm fjalimet patetike me Europë, ku kredoja e fillimit ngjan outdated dhe integrimi europian është vazhdimisht në uploading.

Qeveria shqiptare ka qenë e pafuqishme për ta ndërruar paradigmen, si së jashtmi ashtu dhe së brendshmi. E detyruar të luajë në kufijtë e saj, pra ta pranojë paradigmen, edhe pse ajo nuk punon (aktualisht) për të, por në njëfarë mënyre kundër tyre, Rama me të tjtë janë munduar to think outside the box, duke dalë kaq shumë jashtë saj, sa më shumë se një proces krijim-

shkatërrimi ndërtuan një dhomë jehone (ecco chamber) për veten. Integrimi, në këtë hapësirë vetëngushëlluese pr-i, humbi çdo kuptim dhe u kthye në nuskë që u shpërndahej gjithë atyre që i besonin më shumë 'partisë' së fakteve të ftohta dhe të ashpra.

Ky repertor regjistroi, për shembull, një tuit të famshëm të kryeministrit ku daullet e festës u çanë në nder të çeljes së negociatave edhe para katër viteve. Apo më tej, një 'referendum' apo 'këshillim kombëtar' ku u kërkohej mendim qytetarëve shqiptarë nëse ata ishin për deçiftim nga Maqedonia e Veriut, apo jo. Krijimi i idesë së një rajoni me dy shpejtësi integrimi, siç para më shumë se një dekadë flitej për një Europë të dy shpejtësive, veriu dhe jugu, nuk bëhej si përgjigje përkundrejt paradigmës së madhe të integritit, por përkundër idesë së dizintegritit të brendshëm politik. Duhet shpikur gjithmonë një recetë kundër dështimit.

Pasë kaluar mbi fushën e minuar të këtyre tetë viteve mosintegrim, hapja e negociatave më 20 korrik nuk duhet parë si happy end. Gjasat janë që Shqipërisë t'i çelen negociatat, por edhe kalendat greke.

Qeveria Rama nuk ka në favor as rekordet e veta, por as tendencat globale. Shqipëria është bërë një vend lehtësisht i shmangshëm. Ajo nuk ofron rezistencë si Serbia, dhe as nuk është një vend ku historia mund të bëjë luftë në çdo kohë si Maqedonia e Veriut. Ajo nuk është e krishterë si Kroacia dhe Sllovenia, të anëtarësuara shumë më herët, dhe as një xhep i gatshëm për fëmijën e radhës të kangurit rus në siujdhesën e poshtme të Europës.

Shqipëria është një artefakt politik i pakeluar si 'aleat i dhënë një herë e përgjithmonë'. Në këtë kuptim, marrdhënien me Amerikën dhe me Europën e ka si hebrejtë me Zotin. E ka premtimin e tyre për mbrojtje, por Zoti e di kur kolonët do të kthehen në banorë të kontinentit.

Ky shkrim është pjesë e serise së shkrimeve rreth integritit evropian, të Institutit Shqiptar të Medias, në kuadrin e Programit të Promovimit të Tranzicionit të Republikës Çeke.